



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 649/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.09.2017, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal”, me nr. REF-71229-03-09-2017, me fond limit 76,573,764 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.

Ankimues:

B.O.E “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k.
Adresa: Lagjia nr.2, Pallati 46, Sarandë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Sarandë
Adresa: Rruga “Abedin Dino”, Lagjia nr. 1, Sarandë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga B.O.E ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, B.O.E ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. B.O.E kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të B.O.E ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 10.03.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstrukcion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal”, me nr. REF-71229-03-09-2017, me fond limit 76,573,764 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.

II.2. Në datën 15.03.2017 pala ankimuese “MANE/S” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kriteret e veçanta të kualifikimit për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 17.03.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.875/1 prot datë 17.03.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik “MANE/S” shpk, lidhur me modifikimin e dokumentave të tenderit.

II.4. Në datën 27.03.2017 pala ankimuese “MANE/S” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 21.04.2017 Komisioni Prokurimit Publik me vendimin KPP 244/2017 ka vendosur si më poshtë:

“1.Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Mane/S” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstrukcion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal” me nr. Ref 71229-03-09-2017 me fond limit 76,573,764 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 31.03.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mane/S” sh.p.k. 46 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

II.6.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur informacion lidhur me zbatimin e vendimit KPP 244/2017 dhe si rrjedhojë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka vendosur për heqjen e pezullimit për procedurën e sipërcituar.

II.7 Në datën 15.05.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.8. Në datën 07.06.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- i. “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. 59,999,999 lekë, skualifikuar;
- ii. ”TOTILA” sh.p.k & ”FUSHA” sh.p.k. 74,087,003 lekë, kualifikuar;

II.9.Në datën 07.06.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar B.O.E “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tyre, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

“1.Nuk permbush kriterte e DST-1 konkretisht:Beis vertetimi i OSHEE MË DATË 27.04.2017 2.”Mane/s”SH.P.K nuk plotëson kriterin 2.1.1 ,objekti i prokurimit nuk është në objektin e veprimtarisë të operatorit ekonomik i cili ka për objekt.”Ndërtim,projektim ,laborator import-eksport,grumbullim i mbetjeve të ngurta. 3.Green Farm nuk plotëson kriterin 2.1.1 , objekti i prokurimit nuk është në objektin e veprimtarisë të operatorit ekonomik. 4. Green Farm nuk ka liçensë sipas modelit të lëshuar nga MPPT po ka liçensë nga QKL për prodhim dhe trgëtim I fidanëve dhe bimëve edhe kjo nuk përputhet me zërat e punimeve që do të kryejë pasi janë furnizim vendosje. 5. Green Farm mungon AUDITI i bilanceve për vitin 2015 6.ISO e Green Farm nuk janë për objektin që prokurohet . 7.Mungon Eskavatori me krahë të gjatë. 8.Shoqëritë Beis dhe Green Farm nuk janë të pajisura me vërtetim nga Zyra e Financës dhe Tatim –taksave të Bashkisë Sarandë ,për të vërtetuar që nuk kanë detyrime të papaguara,por thjesht kanë bërë një vetëdeklarim 9.Kompresori i Ajrit nuk ka të dhëna që është monofazë 100 cm 2. 10.Kontrata e ngjashme e Mane sh.p.k nuk e plotëson 45.4 % të vlerës së punimeve që ka marrë,pasi zëri I punimeve shtesë binderi 6 cm që ka marrë përsipër të kryejë Shoqëria Mane/ sh.p.k me atë çka paraqitur për punë të ngjashme i takon të marrë 29.5 % të punimeve. 11.Faturat tatimore të punëve të ngjashme fotokopje

,vetëm me vulë të shoqërisë “Mane/s”sh.p.k . 12. Kanë tre kamioncina,1.4-2 Ton nga katër të kërkuara (kanë paraqitur shumë por janë me më shumë ose më pak se kapaciteti i kërkuar) 13..Rul për shtesat kapaciteti 17 ton është vetëm 1 nga 2 të kërkuar jane paraqitur dhe te tjera por nuk specifikohet tonazhi. 14.Mungon autoboti i naftës (është paraqitur një nga Beis i marë me qera nga Kastrati që vetëm emir i file është autobot nafte se nuk dallohet në është naftë apo ujë po te Shtojca 9 është paraqitur si autobot uji.). 15.Ka vetëm një teknik topograf nga dy të kërkuar ne dst pika 4 paragrafi IV. 16 .Në bazë të DST pika 11. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9),kërkohet : “ Fabrike asfalti ose mobile Icopë Pronësi , qera ose me kontrate furnizimi a) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese). b) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor.(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). c) Fabrika e asfaltit te ofertuesit duhet te jete ne nje distance jo me te madhe se 50 km ose mobile duhet ta kete te shoqeruar me dokumentin e pronesise, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B. Ne rast se fabrika e asfaltit nuk eshte ne pronesi do te paraqitet nje akt mareveshje noteriale ku te te pasqyrohet sasia, cilesia, periudha e furnizimit si dhe penalitet ne rast te mosrespektimit te kushteve te aktmarveshjes(bashkangjitur akti i pronesise si dhe leja mjedisore nga QKL per fabriken.) “ Për të plotësuar këto kërkesa OE-MANE/S sh.p.k ka paraqitur kontratën e qerasë Nr.505 Rep.Nr.235/2 Kol më datë 14.03.2016 ,me palë : 1.Qeradhënësi :Shoqëria “Arti”sh.p.k DHE 2.Qiramarrësi: MANE/S sh.p.k. Objekti:..... Fabrike asfalto betoni. Në DST pika 11,gërma b:” Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor.(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). Subjekti MANE/S sh.p.k. ka deklaruar se: “Deklaroj me përgjegjësi se stafi teknik,mjetet dhe pajisjet tona do të angazhohen me kohë të plotë për ekzekutimin e kontratës.....Ato nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të shpallura fituese.” Konstatohet se Fabrika e Asfaltit ,e përcaktuara në shtojcën 9, konkretisht “Fabrike asfalto betoni ”, eshte e angazhuare në tenderin me objekt “Ndërtim dhe asfaltim i rrugës nr. 5 Loti II dhe III”, në proces ndërtimi ku sipas kontratës Nr.14 Prot.datë 11.06.2015 ,procedurë prokurimi në të cilën është pjesëmarrës vetë qiradhënësi “Arti “SH.P.K ,DHE OBJEKTI ËSHTË NË PROCES NDËRTIMI.”

II.9.1. Në datën 12.06.2017 B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më posht vijon:

“[...]Sqarojme se vertetimi i paraqitur nga shoqeria BE-IS sh.p.k eshte i rregullt si nga ana formale dhe nga permbajtja, totalisht i nxjerre ne respektim te vkm 379 date 11.06.2014 e cila eshte pasqyruar ne VKM 914 date 29.12.2014, neni 26, pika 7.c ku ne menyre eksplicite eshte shprehur: -një vërtetim që konfrmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjiisë elektrike të kontratave të energjisë që ka o eratori ekonomik , që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar

nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga Operatori ekonomik.

Sipas vërtetimit nr. 62 prot. date 27.04.2017 vërtetohet se shoqëria BE-IS sh.p.k rezulton të ketë 0 detyrime për faturat e energjisë elektrike me vlerë të llogaritur deri në datë 27.04.2017 duke përfshirë fakturën koherente të muajit mars 2017. Duke qenë se faktura e muajit prill 2017 del në muajin maj 2017 dhe sipas kontratës së furnizimit me OSHEE sh.a ke afat për shlyerje deri në datë 31.05.2017 shoqëria BE-IS sh.p.k nuk rezulton debitore në datën e hapjes së tenderit 15.05.2017 ndaj OSHEE pasi fakturën e muajit prill mund ta paguaj deri në 31.05.2017 sipas kushteve të kontratës së furnizimit. Në kushtet kur shoqëria BE-IS ka paguar fakturën e mars 2017 dhe nuk rezulton debitore për muajin prill 2017 skualifikimi që autoriteti juaj bën me këtë arsyezim vjen ndesh me kërkesat e nenit 26 pika 7.c e VKM 914 datë 29.12.2017 që saksionon këtë, kriter.

2.MANE/S sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.1.1, objekti i prokurimit nuk është në objektin e veprimtarisë të operatorit ekonomik i cili ka për objekt "Nderim, projektim, laborator import-eksport, grumbullim i mbetjeve të ngurta.

Ju bëjmë me dije se në respektim të nenit 46, pika 1.ç, të LPP, shoqëria MANE/S sh.p.k gëzon zotësi juridike, për të lidhur kontratë për këtë objekt tenderi, pasi ajo sic edhe ka të percaktuar në objektin e veprimtarisë së saj sipas QKR-së, ka si objekt veprimtarie "NDERTIM" pa e limituar objektin e veprimtarisë në fushën e ndertimit, në ndertim rrugësh, urash, objekte civile, elektrike, hidraulike, ujsjelles, kanalizime, apo ndertime të çfaredolloji qofshin ato. Për shoqëria jone e përbushe me se miri kriterin që objekti i prokurimit të përkojë me objektin e veprimtarisë së OE, pasi po të shkojmë akoma më tej, shoqëria jone është e licensuar MPPT për zbatim punimesh për keto kategori punimesh që përfshin preventivi i objektit, ka realizuar punë të ngjashme me objektin e prokurimit sic edhe provohet me kontratë të ngjashme të paraqitura në këtë tender, si edhe ka paraqitur faktura tatimore në organe tatimore për realizimin e këtyre punëve të ngjashme apo të njëjta me objektin e prokurimit tuaj, duke u legjitimuar si nga organet tatimore, por edhe nga ato shtetërore.

3.Green Farm nuk plotëson kriterin 2.1.1, objekti i prokurimit nuk është në objektin e veprimtarisë të operatorit ekonomik.

Ju kujtojmë këtu që shoqëria Green Farm sh.p.k është lider në tregtim dhe krijimin e fidanishteve, prodhimin dhe rritjen e pemëve dekorative si dhe import-eksportin e tyre.

Gjithashtu sic edhe ju e keni pranuar, duke i dhënë një vëmendje të vecantë zërit të preventivit për fidane dhe pemë dekorative duke e blinduar me kriterë dhe kërkesa për staf të kualifikuar në fushën e rritjes dhe kultivimit të pemëve dekorative, kjo shoqëri sipas ligjit sektorial që rregullon këtë veprimtari (ju kujtojmë këtu arsyetimin e KPP-së lidhur me këtë pikë në vendimin 244/2017 vendim i marrë për autoritetin tuaj) e përbushe plotësisht kriterin që objekti i veprimtarisë tone nuk përkon me objektin e tenderit. Objekti i tenderit ndër të tjera është edhe gjelberim dhe furnizim vendosje pemë dekorative, ze të cilin e ka marrë përsiper sipas kontratës së bashkëpunimit shoqëria "Green Farm" sh.p.k. Në respektim të nenit 46, pika 1.ç, të LPP, shoqëria "Green Farm" sh.p.k gëzon zotësi juridike për realizimin me sukses të atij zëri punimesh që është angazhuar të realizojë, ze i cili ze në total 2.3 % të punimeve. Kjo shoqëri gëzon të gjitha kapacitetet, ligjore, teknike, stafin teknik dhe mjetet dhe pajisjet për të realizuar me sukses, ato zëra punimesh të cilat ka marrë përsiper.

Referuar nenit 46,7.ç, citojmë,

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontratë prokurimi ose në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Kjo pike ka gjetur rregullim te vecante duke e diferencuar rastin e bashkimit te operatoreve nga ai i operatorit ekonomik. Dispozitat ligjore duhet te interpretohen ne menyre korrekte dhe ne varesi te njera tjetres, te pa shkeputura nga konteksi i te gjithes.

4.Green Farm nuk ka license sipas modelit te leshuar nga MPPT po ka license nga QKL per prodhimin dhe tregetim i fidaneve dhe bimeve edhe kjo kjo nuk perputhet me zerat qe do te kryej pasijane fumizim vendosje.

Skualifikimi juaj sipas ketij argumenti vjen ndesh me qendrimin e KPP-se (244/2017 vendim i marre per autoritetin tuaj per kete procedure tenderi) lidhur me kete kriter te vendosur nga ana juaj ne menyre te kundraligjshme dhe totalisht diskriminuese, ne raport me parashikimet ligjore dhe rregullimin qe i ben ligji sektorial, perkatesisht vendimit nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te Zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi" licensa te cilat jepen ne zbatim te ketij vendimi nga MPPT .

Edhe ju si autoritet pasi e keni kuptuar gafen e madhe qe kishit bere me kete kerkese, ku referuar vendimit nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", agronomi nuk mund te vendoset drejtues teknik ne license zbatimi punimesh pasi nuk ka asnje kategori punimesh qe te parashikojne ne licensa zbatimi punen e agronomit, e keni hequr kete kriter te paligjshem nga kerkesat per kualifikim te parashikuara ne DT.

Akoma me tej gafa me e madhe nga ana juaj eshte qe keni kerkuar nje person me TITULL INXHINIER AGRONOM nderkohe qe titulli INXHINIER AGRONOM nuk ekziston, por thjesht AGRONOM I LARTE, por me sa duket edhe ai qe ka vendosur kriterin ne bashkepunim me ju nuk e di qe vet nuk eshte inxhinier por thjeshte AGRONOM I LARTE.

Green farm sh.p.k, ne baze te punimeve qe ka marre persiper, duhet te disponoje license nga QKB sic edhe e ka paraqitur ne SPE, per te provuar se eshte e licensuar sipas ligjit sektorial (pra sipas vendimit te KPP) per kryerjen e punimeve qe ka marre persiper, pra kategoria nr. 3 punime te ndryshme , per mbjellje bari dhe fidane peme dekorative.

Skualifikimi juaj me argumentin qe Green farm sh.p.k, nuk ka license nga MPPT shkon pertej absurdit, per te mos thene qe eshte mosnjohje totale e ligjit dhe paaftesi totale e anetareve te KVO. Per me teper nje kerkese e tille nuk eshte parashikuar ne asnje nga kerkesat per kualifikim, te vendosura ne DT, pasi ky ze nuk korrespondon me asnje nga pikat e licenses se zbatimit te kerkuar nga ju ne kete tender, citojme:

- NP-1C (Punime germimi toke)
- NP-4C (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai metro, pista aeroportuale) .
- NP-5B (Punime nentokesore, ura dhe vepra arti)
- NP-12C (Punime te inxhinierise se Mjedisit)
- NS-6A (Shtresa dhe mbistruktura speciale)
- NS18B (Punime Topogjeodezike)

5.Green Farm mungon auditi i bilanceve per vitin 2015.

Perseri jemi te detyruar tju orientojme te lexoni ligji Nr.10091, datë 5.3.2009 i ndryshuar, neni 41, pika c e tij citojme :

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të

mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 40 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 30 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Ne kushte kur shoqeria Green farm sh.p.k nuk permbush 2 prej 3 treguesve që cituam më lart nuk është subjekt i auditimit nga një ekspert kontabel i licensuar dhe konform legjislacionit nuk ka detyrimin të bëjë auditimin e bilanceve.

6. Iso e Green Farm nuk janë për objektin që prokurohet.

Shoqeria Green Farm sh.p.k ka paraqitur të gjitha certifikata ISO të kërkuara, në DT, të leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këto qëllim dhe janë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Për shoqëri Green Farm e ka plotësuar kriterin e vendosur nga ana juaj në DT, në asnjë pikë të kushteve të vecanta për kualifikim nuk është kërkuar që certifikata duhet të jenë të njëjta me objektin e tenderit, ndaj arsyetimi juaj që ISO e Green Farm nuk janë për objektin e tenderit është i pambeshtetur si në kriteret e vendosura ashtu edhe po të referohemi zerit të punimeve që ka marrë përzier të realizojë kjo shoqëri në bazë të kontratës së bashkëpunimit. Shoqeria Green Farm certifikatat i ka në përputhje të plote me aktivitetin që kryen si edhe me zërat e preventivit që ka marrë përzier të realizojë në këto objekt prokurimi. Në këto kushte arsyetimi juaj për ta në skualifikuar nuk qëndron dhe është i pambeshtetur si në ligjë ashtu edhe në kërkesat e DT.

7. Mungon eskavatori me krahe të gjatë. B.O "MANE/S" sh.p.k & "BE-IS" sh.p.k & "GREEN FARM" sh.p.k ka paraqitur 3 mjete të tilla me krahe të gjatë për germime në kanale në prezencë uji me thellesinë të mëdha që realisht ky preventiv që ju keni hedhur në tender nuk i përfshin fare këto zëra punimesh dhe është vendosur në kundërshtim me ligjin e hartimit të manualeve të ndërtimit ku sipas zerave të punimeve duhen të vendosen edhe makinerit dhe mjetet përkatëse.

Akoma me tej shoqeria "MANE/S" sh.p.k ka paraqitur në SPE dy mjete me krahe të gjatë me qerë :
1) eskavator me numër shasie FAY2186 me kontratë qeraje numër rep. 1301 nr.118/1kol., datë 31 mars 2014, me afat 5 vjeçar, shoqëruar dhe faturë zhdoganimit, përse i përket emërtimit eskavator krahegjatë nuk është fajti jone pasi në faturën e zhdoganimit nuk është cilesuar ky kriter dhe kontrata e qerës për noterit është bërë në bazë të këtij dokumenti identifikues. Gjithashtu nuk është fajti jone që autoriteti juaj nuk ka kërkuar foto për ta identifikuar me qarte mjetin, në japim garanci ashtu siç edhe kemi plotësuar shtojcën mbi disponimin e makinerive që ky mjet është eskavator krahegjatë gjithashtu paraqitja e këtij mjeti nga ana jone është bërë në koherencë të plote me plotësimin dhe paraqitjen e shtojcës nr.5 deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike ku në deklarojmë se i Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikatën e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, përse në koherencë të kësaj deklarate në e quajmë të përmbushur këto kriter! Gjithashtu në kemi deklaruar se autoriteti kontraktor lejohet të bëjë verifikimin dhe kontrollin e mjeteve dhe pajisjeve në çdo kohë, verifikim i cili nuk është realizuar nga ana juaj edhe pse keni ngritur dyshime lidhur me eskavatorin me krahe të gjatë.

2) mjet germimi CAZAGRANDE C 600 me krahe mbi 15ml deri në 42 ml (shiko katalogun e mjetit i cili është i shoqëruar me kontratë qeraje numër rep. 1357 nr.247 kol datë 20 prill 2017, me afat 5 vjeçar, faturë zhdoganimit, foto të mjetit ku janë paraqitur dy tipet e km me për germim, janë paraqitur foto të mjetit duke germuar kanale ku shfaqet dukshëm dhe qarte që ky mjet plotëson kriterin e DST.

3) Shoqeria "BE-IS" sh.p.k ka paraqitur eskavator krahegjatë në pronësi me akses 18 m me numër shasie R3277 me faturë zhdoganimit 27/03/2007, që vërteton pronësinë. Gjithashtu nuk është fajti jone që autoriteti juaj nuk ka kërkuar foto për ta identifikuar me qarte mjetin, në japim garanci

ashtu sic edhe kemi plotesuar shtojcen mbi disponimin e makinerive qe ky mjet eshte eskavator krahagjate gjithashtu paraqitja e ketij mjeti nga ana jone eshte bere ne koherence te plote me plotesimin dhe paraqitjen e shtojces nr.5 deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike ku shoqeria "BE-IS" sh.p.k deklaroi se i Permbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, pra ne koherence te kesaj deklarate ne e quajme te permbushur kete kriter! Gjithashtu BE-IS sh.p.k. ka deklaruar se autoriteti kontraktor lejohet te beje verifikimin dhe kontrollin e mjeteve dhe pajisjeve ne cdo kohe, verifikim i cili nuk eshte realizuar nga ana juaj edhe pse keni ngritur dyshime lidhur me eskavatorin me krah te gjate. 9. Shoqeria BE-IS dhe Green Farm nuk jane te pajisura me vertetim nga zyra e Finances dhe Tatim -Taksave te bashkise Sarande per te vertetuar qe nuk kane detyrime te papaguara, por thjeshte kane bere vete deklarim.

Sqarojme se shoqerite Be-Is dhe Green Farm sic edhe mund te verifikohet nga ekstrakti historik nuk kane ushtruar asnjehere aktivitet ne territorin e bashkise Sarande dhe ne kuptim te ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar "Per sistemin e taksave vendore" persa kohe nuk ke ushtruar aktivitet ne territorin e nje bashkie nuk ke sesi te rezultosh debitore. Akoma me tej mbeshtetur ne nenit 46, 1 te LPP-se ku ne menyre eksplicite shprehet : Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Ky kriter i vendosur nga ana juaj jo vetem nuk eshte i mbeshtetur ligjesisht, pasi nuk ka asnje dispozite ligjore ku te sanksionohet kerkesa juaj per tu pajisur me vertetim nga zyra e Finances dhe Tatim -Taksave te bashkise Sarande per te vertetuar qe nuk kane detyrime te papaguara per me teper eshte diskriminues dhe ka per qellimi cenimin e fshehtesise se procesit te prokurimit dhe identifikimin e operatoreve pjesemarres qe ne fazen paraprake te procesit te tenderimit.

Ne interpretim te ketyre dy dispozitave nenit 45 dhe neni 46, kriteri per te cilin ju na keni skualifikuar nuk gjen mbeshtetje ligjore dhe eshte vendosur ne kundërshtim me kerkesat e ketij ligji.

Per me teper te dyja shoqerit BE-IS dhe Green Farm kane deklaruar nen pergjegjesine e plote se nuk kane asnje detyrim te papaguar perkundrejte bashkise Sarande, gje e cila mund te verifikohet shume lehte nga ana juaj si autoritet kerkues, pasi nepermjet deklarates ne ju kemi autorizuar te beni verifikimet perkatese prane zyrave tuaja te tatim taksave apo zyres se finances. Edhe vete KLSH e ka gjetur shkelje gjate kontrollit qe ka ushtruar (ne bashkine Himare e cila mund te evidentohet lehte ne faqen elektronike te KSLH mbi auditimin e vitit 2017 ne kete bashki), kete kerkese tuajen te paligjshme dhe te vendosur pa asnje baze ligjore si kriter skualifikimi, me arsyetimin se cenon te drejten e fshehtesise se procesit te prokurimit dhe cenon garen e lire dhe te barabarte dhe eshte diskriminues per operatoret pjesemarres pasi dekonspiron pjesemarrjen.

Persa i perket kompresorit te ajrit B.O "MANE/S" sh.p.k & "BE-IS" sh.p.k & "GREEN FARM" sh.p.k ka paraqitur mbi 4 te tille, per te cilet eshte plotesuar edhe shtojca mbi deklaraten e mjeteve dhe pajisje, gjithashtu nuk eshte faji jone qe faturat shoqeruese te kompresoreve te paraqitur ne tender nuk e specifikojne termin monofaze 100cm2 (realisht duhet te ishte cm3), akoma me tej autoriteti juaj nuk ka kerkuar sqarime plotesuese per ta identifikuar me qarte pajisjen, ne japim garanci ashtu sic edhe kemi plotesuar shtojcen mbi disponimin e makinerive qe keto pajisje e plotesojne gjithashtu kriterin kompresor ajri monofaze 100cm2 (realisht duhet te ishte cm3), paraqitja e ketyre pajisjeve nga ana jone eshte bere ne koherence te plote me plotesimin dhe paraqitjen e shtojces nr.5 deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike ku ne deklarojme se i Permbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë

këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë...

10.Kontrata e ngjashme e Mane/S sh.p.k nuk ploteson 45.4% te vleres se punimeve qe ka marre persiper , pasi zeri i punimeve shtese binderi 6 cm qe ka marre persiper te kryej shoqeria Mane/S sh.p.k me ate cka ka paraqitur per pune te ngjashme i takon te marre 29.5% te punimeve.

Ju sjellim ne vemendje se oferta jone eshte paraqitur si bashkim operatoresh:

-Mane/S sh.p.k me 45.4% te pjesemarrjes Be-ls sh.p.k 52.3% te pjesemarrjes -Green Farm sh.p.k 2.3% te pjesemarrjes. Ne respekt te nenit 74, pika 3, te VKM 914, date 29.12.2014 i ndryshuar, ku ne menyre eksplicite parashikohet:

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme ne raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Megjithate ne respektim te nenit 74 te VKM 914 pika 3, ne kemi paraqitur te ngjashme dhe pune identike, e cila jo vetem e permbushe vleren e kerkuar (50% te fondit limit) por e tejkalon disa here:

1. Rikonstrukcion i Qendres Konispol” me vlere te realizuar 38,845,612 leke.

2. “Projekt i shetitores buze detit, Qeraro” me vlere te realizuar 75,999,990 leke.

Sipas perlllogaritjeve kontrata e ngjashme: fondi limit 76,573,764 leke * 50% =38 296.882 leke

Kontrat te ngjashme qe duhet te paraqese MANE/S sh.p.k me pjesemarrje 45.4% *38,296,882 = 17,425,081 leke.

Po ti referohemi zerave te punimeve qe ka marre persiper shoqeria "MANE/S" sh.p.k, rezulton qe nuk ka marre persiper te realizoje vetem shtrese binderi por edhe te gjithë zerat e kategorise nr.2 punimeve ne vepra arti te vogla ndaj argumenti juaj nuk qendron dhe eshte totalisht i pambeshtetur ne ligj.

Pra pretendimi juaj se ne nuk plotesojme kriterin per kontrata së njëjtës natyrë ndonese eshte kriter i vendosur me kundeshtim me ligjin, ku kemi paraqitur punime te realizuar vetem per nje ze ne vleren 13,607,000 leke, nuk qendron, eshte diskriminues dhe ne kundeshtim me parashikimet ligjore. Ne keto kushte kerkojme nga ana juaj te korrigjoni shkeljet ligjore dhe te konsideroni te permbushur kete pike.

11.Faturat tatimore e puneve te ngjashme fotokopje, vetem me vule te shoqerise "Mane/S"sh. p. k.

Sqarojme se faturat tatimore jane te vulosura me vule nuk jane fotokopje. Faturat e paraqitura ne SPE jane te vulosura me vule te njome te shoqerise Mane/s dhe te Bashkise Konispol sic e dhe mund te evidentohet shume lehte ne dokumentacionin e dorezuar me emertimin e SHTOJCA 6 QENDRA KONISPOL DHE RRUGA HYRESE.

12. kane tre kamioncina 1.4-2 ton nga kater te kerkuara(kane paraqitur shume por jane me me shume ose me me pak se kapaciteti i kerkuar.

Persa i perket kamioncinave ashtu sic e specifikon edhe vete autoriteti tek skualifikimi kemi paraqitur me shume se 4 te tilla, me poshte po sqarojme shoqeria "MANE/S" sh.p.k, ka paraqitur konkretish :

1. kamioncine me qera me targa SR 5513 B me tonash i shenuar ne lejen e qarkullimit nga 1665 kg masa e mjetit bosh 2515 kg masa e mjetit maksimale e autorizuar.

2. kamioncine me qera me targa AA69S OM me tonash i shenuar ne lejen e qarkullimit nga 1840 kg masa e mjetit bosh 2830 kg masa e mjetit maksimale e autorizuar.

3.Shoqeria green farm sh.p.k ka paraqitur ne pronesi kamioncinen me targa AA 334 NY OM me tonash i shenuar ne lejen e qarkullimit nga 2180 kg masa e mjetit bosh 3300 kg masa e mjetit maksimale e autorizuar.

4.SHOQERIA "BE-IS" sh.p.k ka paraqitur me qera kamioncinen me targa AA 660 ED me tonash i shenuar ne lejen e qarkullimit nga 2200 kg masa e mjetit bosh 3500 kg masa e mjetit maksimale e autorizuar.

5.ka paraqitur me qera kamioncinen me targa AA 359 KA me tonash i shenuar ne lejen e qarkullimit nga 2200 KG masa e mjetit bosh 3500 kg masa e mjetit maksimale e autorizuar.

6.ka paraqitur me ne pronesi kamioncinen me targa AA 660 ED me tonash i shenuar ne lejen e qarkullimit nga 3125 KG masa e mjetit bosh 6600 kg masa e mjetit maksimale e autorizuar.

Pra sic duket qarte kamioncinat e paraqitura ne SPE nga bashkimi tone i Operatoreve ekonomike e ploteson kriterin maksimal 2 ton por ne disa raste dhe e tejkalon ate kjo nuk do te thote qe keto mjete nuk e kryejne funksionin per te cilat jane kerkuar por kur ngarkesa e tyre eshte disi me e madhe se ajo e kerkuar ne DST kjo eshte ne avantazh dhe ne te mire te punes pasi do ti ule koston e punimeve BO tone.

13. Rul per shtresat kapaciteti 17 ton, eshte vetem 1 nga 2 te kerkuar jane paraqitur dhe te tjera por nuk specifikohet tonazhi.

Persa i perket rulave 2 cope me kapacitet 17 ton jane paraqitur 2 cope, 1 rul tipi bomag ne pronesi te shoqerise "BE-IS" sh.p.k, me tonazh 19 ton me fature blerjeje 1444 date 20/05/2016 me cmim blerjeje 2,610,000 leke me TVSH ku ne dokumentat shoqeruese te mjetit fature zhdoganimi dhe fatura blerese jashte shtetit evidentohet qarte pesha 19 ton.

1 rul tipi dynapoc me qera te marre nga shoqeria "MANE/ S" sh.p.k nga shoqeria SYNERGY me numer shasie 68 74 10831 shoqeruar me fature shitblerjeje nr.4 date 09/02/2013 me cmim blerjeje 3,185,160 leke te reja me TVSH, ashtu sic evidentohet edhe nga cmimi shume i larte per te cilat shiten vetem rula mbi 17 ton, argumentohet qarte tonazhi per te cilen ne kemi plotesuar deklaraten mbi makinerite si dhe paraqitja e ketij ruli nga ana jone eshte bere ne koherence te plote me plotesimin dhe paraqitjen e shtojces nr. 5 deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike ku ne deklarojme se i Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë...

14.Mungon autoboti i naftes (eshte paraqitur nje nga BE-IS i marre me qira nga Kastrati qe vetem emri i file eshte autobot nafte se nuk dallohet ne se eshte nafte apo uje po te shtojca 9 eshte paraqitur si autobot uji).

Ju sqarojme se ne SPE shoqeria BE-IS sh.p.k ne shtojcen nr. 9 per disponimin e mjeteve, seksioni i mjeteve me qira me targe AA968J L me kontrate qiraje Nr.111 rep. Dhe nr.46 kol. Date 10.01.2017 me afat 2 vjecar, me ana te se ciles eshte marre me qira autobot nafte, nga shoqeria me e madhe e karburanteve ne vend, ku referuar dokumentacionit bashkelidhur kontrates se qirase, ku mjet disponon certifikate transporti nr. 50 date 13.04.2016 me afat deri ne 10.04.2021 te leshuar nga Drejtoria e sherbimit te transportiot rrugor, per trasport mallrash te rrezikshme ku perfshihet nafta, pasi eshte evidente qe uji nuk eshte mall i rrezikshem si dhe referuar certifikates se konformitetit dhe cilesis rrugore te ketij mjeti, ne shenimet e bera per kete mjet gjate inspektimit, rezulton qe shenimi eshte bere : Karburant klasa 3. Pra sic edhe mund te evidentohet shume qarte, autoboti me targe AA968JL, eshte autobot nafte dhe jo uji sic edhe ju e keni cituar ne menyre te pambeshtetur ne argumentin tuaj.

14. ka vetem nje teknik topograf nga dy te kerkuar ne dst pika 4, paragrafi IV. Referuar dokumentacionit te paraqitur rezulton se shoqeria mane/s sh.p.k, ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per teknik topograf z. Preng Rica dhe inxhinier gjeodet (topograf) z. Marseld Ahmetaj, Ndersa shoqeria BEJS sh.p.k, ka paraqitur dokumentacioni e kerkuar per inxhinier gjeodet Arben Sulkurti dhe inxhinier markshajder (topograf) z. Hamz Islamaj i pajisur edhe me license per

rilevime topografike dhe punime topogjeodezike. Pra bashkimi jone i operatoreve jo vetem qe ploteson numerin e inxhinierëve gjeodet (topograf) te kerkuar nga ju gjithesej 2 ing. gjeodet, por ploteson edhe kriterin e pikes iv ku kerkohen 2 teknik topograf pasi ka nje teknik topograf dhe tre inxhiniera gjeodet (topograf) ku njeri prej te cileve ploteson kriterin e nje tekniku topograf pasi, inxhieri gjeodet eshte i kualifikuar te kryej edhe punen e teknikut topograf pasi ka nje kualifikim te nje niveli me te larte arsimore ne po kete fushe te topografise. Inxhinieri gjeodet gezon te gjithë kualifikim e duhur, per te bere edhe punen e teknikut topografar i cili ka kualifikim me te ulet, ndersa tekniku topograf nuk mund te beje punene e inxhinierit gjeodet per shkak se ky i fundit ka nje kualifikim me te larte...

16. ne baze te DST pika 11, deshmi per mjete dhe pajisje teknike qe ka ne dispozicion apo mund te vihen ne dispozicion operatorit ekonomik , qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates (shtojca 9) kerkohet : fabrike asfalti ose mobile 1 cope pronesi, qira ose me kontrate furnizimi a) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) b). Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). c). Fabrika e asfaltit te ofertuesit duhet te jete ne nje distance jo me te madhe se 50 km ose mobile duhet ta kete te shoqeruar me dokumentin e pronesise, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III. 1B. Ne rast se fabrika e asfaltit nuk eshte ne pronesi do te paraqitet nje akt mareveshje noteriale ku te pasqyrohet sasia, cilesia, periudha e furnizimit si dhe penalitet ne rast te mosrespektimit te kushteve te aktmarveshjes(bashkangjitur akti i pronesise si dhe leja mjedisore nga QKL per fabriken.

b) Per te plotesuar keto kerkesa OE Mane/S ka paraqitur kontraten e qirase me nr. 505 rep. Nr. 235 /2 kol te dates 14.03.2016, me pale :l. Qiradhenesi shoqeria Arti sh.p.k dhe qiramarresi shoqeria Mane S sh.p.k Objekti Fabrike Asfalto Betoni. Ne DST pika 11, derma b “Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklarat

Si fillim jemi te paqarte persa i perket shenimit tuaj, nese e perrnbushim apo jo kete kriter, pasi jeni shume konfuz ne ate cfare keni shkruar. Megjithate shoqeria jone disponon me kontrate qiraje te lidhur para noterit, konforme dispozitave ligjore ne fuqi fabrike Fabrike asfalti e cila eshte paraqitur ne tender. Nga ana jone kjo fabrike asfalti nuk eshte deklaruar ne asnje kontrate te nenshkruar apo apo ne ndonje procedure tjeter te shpallur fituese sic edhe kemi deklaruar ne kete tender, sipas deklarates tone. Fabrika e asfaltit e marre me qira me kontrate qiraje para noterit nr. 505 rep. Nr. 2350. kol. date 14.03.2016, disponohet nga ana jone dheju keni pasur gjithë mundesite per te bere verifikime sic edhe keni parashikuar ne DT, dhe ne kemi deklaruar vendndodhjen dhe deklarate ku ju autorizojme te kryeni verifikime ne cdo kohe.

Ne zbatim te kesaj kerkese ne kemi paraqitur kontrate qiraje te vlefshme te lidhur para noterit si nje nder format e pranuar nga ju per permbushjen e ketij kriteri. Vendodhja e saj eshte brenda 50 km te kerkuar nga ana juaj ne DT. Kontrata e qirase eshte lidhur per nje afat 2 vjecar. Pra kriteri i mesiperm eshte i plotesuar ne menyre korrekte nga ana jone ndaj nuk e kuptojme skualifikimin qe keni bere lidhur me kete pike. [...]”

II.9.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2223/1 Prot. datë 19.06.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje B.O.E ankimes

“MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k., duke mos e pranuar asnjë prej pikave të ankesës së tij, si dhe ka shtuar një arsye skualifikimi si më poshtë vijon:

”[...]Nga rishqyrtimi i dokumentacionit KVO në bazë të shkresës drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe përgjigjes së kthyer nga kjo Drejtori, vihet re se Drejtuesi Teknik i shoqërisë ”MANE/S” sh.p.k. Ing. Gjergji Klimi figuron i dypunësuar tek subjekti ”MANE/S” sh.p.k. dhe tek OSHEE[...]”

II.9.3.Në datën 20.06.2017 B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10.Në datën 03.07.2017, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2423/1prot., datë 28.06.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues (thema decicendum), në zbatim të nenit 27 pika 2 të Vendimit Nr. 184 të Këshillimit të Ministrave datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se *“Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Në datën 21.04.2017 Komisioni Prokurimit Publik me vendimin KPP 244/2017 ka vendosur si më poshtë:

“1.Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Mane/S” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal” me nr. Ref 71229-03-09-2017 me fond limit 76,573,764 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 31.03.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mane/S” sh.p.k. 46 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

III.1.2. Në datën 15.05.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Në datën 07.06.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- i. “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. 59,999,999 lekë, skualifikuar;
- ii. “TOTILA” sh.p.k & “FUSHA” sh.p.k. 74,087,003 lekë, kualifikuar;

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur informacion lidhur me zbatimin e vendimit KPP 244/2017 dhe si rrjedhojë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka vendosur për heqjen e pezullimit për procedurën e sipërcituar. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka kryer modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit në përputhje me kontaktimet në vendim dhe akoma më tej nuk ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik në përputhje me pikën 4 të dispozitivit në të cilin urdhërohet autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni KPP lidhur me zbatimin e vendimit me qëllim heqjen e pezullimit nga KPP dhe lejin e autoritetit kontraktor për vazhdimin e hapave të tjerë procedurialë, veprim i cili nuk rezultoi të jetë kryer pasi autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm procedurialë konkretisht hapjen dhe vlerësimin e ofertave pa një vendim të Komisionit që e lejon këtë të fundit për vijimin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër KPP gjykon se “Hapjen e Ofertave” dhe “Vlerësimin e Ofertave” është kryer në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik lidhur me respektimin e afteve proceduriale të ankimit si dhe me urdhërimet në vendimin nr. 244/2017 datë 21.04.2017 të Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara proceduriale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.1.6. Në nenin 19/1, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në këtë ligj...në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.”

III.1.7. Ndërsa, në nenin 31, të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, theksohet : *“Autoritetet kontraktore, nëse brenda 10 ditëve nga marrja dijeni, nuk kërkojnë pranë Komisionit rishikimin e vendimit të tij, janë të detyruara ta zbatojnë atë në përputhje me urdhërimet e tij”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se në mbështetje të dispozitave ligjore të lartpërmendura, autoritetet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me rigorozitet vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik dhe të kryejnë modifikimin e dokumentave konform konstatimeve të pasqyruara në këto vendime, ndërkohë që operatorët ekonomikë të cilët gjykojnë se kriteret çenojnë interesin e tyre të ligjshëm për pjesmarrje në procedurë, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre, gjithnjë duke mbajtur në konsideratë afatet ligjore të përcaktuara.

III.1.8. Në nenin 28 pika 2 gërma “d” të VKM, nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se *“[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”*. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vijuar me procedurën pa respektuar vendimin nr. 244/2017 date 21.04.2017 të KPP-së. Komisioni gjykon se pretendimet e BOE ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Mosmarrjen në shqyrtim në themel ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rikonstruktion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal*”, me nr. REF-71229-03-09-2017, me fond limit 76,573,764 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e vendimit nr. 244/2017 datë 21.04.2017 të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. & “Green Farm” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1131 protokoli Datë 20.06.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

